

VRASJA
Shahin Toçi lindi më 30 tetor të vitit 1918 në Mat. Ai u diplomua në Akademinë Ushtarake të Romës. Vetëm dy javë pasi refuzoi të betohej para hierarkisë fashiste, studenti shqiptar u gjet i vranë në banesën ku banonte, në rrugën "Trastevere".



NDERIMI
Shahin Toçi është shpallur "Dëshmorit Atdheut" në vitin 2004. Ndërsa ka marrë Urdrin e "Flamurit të klasit të parë" në vitin 1994. Në ceremoninë e zhvilluar dje në gytelin e Burrelit, Toçi u nderua me "Medaljen e shqiponjës" nga presidenti Bamir Topi.

BURREL/Historia e të riut nga Mati. Dje ceremonia e nderimit, Topi jep "Medaljen e artë të shqiponjës"

Kthehen eshtrat e dëshmorit Shahin Toçi

72 vite më parë studenti shqiptar refuzoi betimin e Musolinit

Enver Doçi

BURREL
Më 13 maj të vitit 1939, i ri shqiptar Shahin Toçi, student i sapodiplomuar në Akademinë Ushtarake, do të trondiste autoritetet e asaj kohe në Romë. Ditën e betimit, në një ceremoni të blinduar nga trupat italiane, ku morri pjesë dhe nënkretari i luftës Pariani, Toçi u paraqiti me një shirt kuqezi mbi uniformën ushtarake italiane. Ky simbol krijoi pësjtjellim tek oficerët e lartë që ishin prezant në ceremoni, të cilët i kërkuan të riut nga Shqipëria të hiqte menjëherë shirtrin kuq e zi. Toçi jo vetëm që refuzoi të hiqte shirtrin, por nuk pranoi që të betohej. Ai deklaroi: Zoti gjeneral, në jemi shqiptarë dhe betohemi vetëm para flamurit tonë kuq e zi! Vetëm dy javë më pas, studenti shqiptar që sfidoi publikisht Musolinit u gjet i vranë në rrugën "Trastevere" në Romë. Burrëria, patriotizmi dhe sakrificat e djaloshit nga Mati në emër të flamurit kombëtar, është pjesë e historisë tonë. Pas afro 72 vitesh, eshtrat e tij u prehen në vendlindje, në tokën për të cilën dha jetën. Dje u realizua dhe ceremonia e nderimit për adhetarin dhe dëshmorin Shahin Toçi. Në këtë ceremoni morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Arben Imami; deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, Qemal Minxhozi, Fatmir Toçi dhe Bedri Hoxha; ambasadori i Shqipërisë në Romë, Llesh Kola; Princi Leka, drejtues të pushtetit lokal dhe partive politike, etj.



Ceremonia e djeshme në Burrel



Dëshmorit Shahin Toçi

Akademinë Ushtarake të Romës. Studenti Toçi që ndër të parët që hodhen idenë e organizimit të studentëve, për t'u kthyer në Shqipëri dhe për të luftuar për çlirimin e vendit. "Nuk ka mbetur rrugë tjetër, veçse të hedhim armët dhe robën fashiste, e të kthehemi në atdheun tonë. Atje s'ka humbura, as burrëria. Atje mund të organizohemi edhe më mirë, për të hedhur tutje robërinë", - kështu u thoshën djaloshi nga Mati bashkatdhetarëve të tij. Bashkëkohës të tij pohojnë se Toçi u dëshpërua shumë momentin kur kurora mbretërore shqiptare do të dorëzohej në

“ RREFIMI
Bashkëkohës të tij pohojnë se Toçi u dëshpërua shumë momentin kur kurora mbretërore shqiptare do të dorëzohej në Romë nga Garda kombëtare. Megjithatë, ai diti të qëndrojë si një shqiptar i fortë edhe në ato ditë të vështira, edhe pse larg vendit të tij.
Romë nga garda kombëtare. Megjithatë, ai diti të qëndrojë si një shqiptar i fortë edhe në ato ditë të vështira, edhe pse larg vendit të tij.
Më fillim të majit 1939, studentët shqiptarë në Akademinë Ushtarake i mblodhën në një sallë të madhe, për të bërë betimin. Komandanti i Akademisë, pasi u foli studentëve për lidhjet e reja mes Italisë dhe Shqipërisë, i ftoi ata që të bënin betimin fashist, ku angazhoheshin se do të ishin në shërbim të

plotë të Romës. Sipas programit, betimi do të bëhej në një nga sheshet kryeqytetiv italian, në datën 13 maj 1939. Në fakt, kjo ditë shënoi incident të rëndë për autoritetet e asaj kohe në Itali. Kjo për faktin se studenti shqiptar refuzoi publikisht që të betohej për fashizmin dhe Musolinit. Pak ditë më pas dhe pikërisht më 26 maj 1939, Shahin Toçi u gjend i vranë në shtëpinë ku banonte, në rrugën "Trastevere" në Romë. Kjo vrasje e shëmtuar tronditi shqiptarët. Shumë hipoteza u hodhën për shkakun e vdekjes, por e vërteta mbeti e pazbuluar. Shteti italian e arkivoi dosjen Toçi,

ndoshta për të fshehur atë që kishte ndodhur realisht, e që kishte lidhje me aktin e madh patriotik të këtij shqiptari nga Mati.
KTHIMI I ESHTRAVE
Paraditen e së premtes, rreth orës 11:30 mbërritën në Rinas eshtrat e patriotit Shahin Toçi. Ndërsa, në ora 10:00 të ditës së djeshme, në hollin e Bashkisë së Burrelit, në praninë e qindra banorëve nisën homazhet për dëshmorin. Eshtrat e tij u vendosën në varrezat e dëshmorëve të Matit. Ndërkohë, nipi i Shahin Toçit falenderoi gjithë autoritetet dhe institucionet shqiptare e italiane për ndihmën e dhënë. Në fjalën e tij ministri i mbrojtjes Arben Imami pohoi se kjo është një ditë e veçantë jo vetëm për familjen Toçi, por për të gjithë shqiptarët. "Nderim për gjatë atë njerëz që sakrifkuan për flamurin kombëtar. Shahin Toçi është krenaria e djallërisë dhe ushtrisë shqiptare" tha ministri gjatë fjalës së tij. Pas përshëndetjeve të rastit, këshilltarja ushtarake e Presidentit të Republikës, Manushaqe Shehu i dorëzoi nipit të Shahin Toçi "Medaljen e artë të shqiponjës", me të cilën Presidenti Topi nderon dëshmorin e atdheut, pas vdekjes.

Shënohet një i vdekur dhe një tjetër i plagosur në Korçë

Përplasen dy mjete, vdes 22-vjeçarja nga Shkodra

Një 22-vjeçare nga fshati Grizë e Gruemirës dje humbi jetën në aksidentin, ndërsa u plagos rëndë i fejuari i saj. Burime nga policia e Shkodrës bëjnë të ditur se ngjarja ndodhi në lagjen "Lleza" në qytetin e Koplikut. Mësohet se automjeti tip "Benz", me targë MA 1180 B që drejtohej nga Bati Lohja, dhe automjeti tip "Benz" me targë MA 10 67 B, me drejtues Ahmet Cokajin, u përplasën në afërsi të një kishese. Sipas policisë lokale, mjeti i udhërrëftuesit ishte bashku me të fejuarin e saj ka qenë duke lëvizur tonë viktima së bashku me të fejuarin e saj ka dalë nga një rrugë në drejtim të qytetit, ndërsa makina tjetër që ka dalë nga një rrugë dytësore është përplasur me ta. Si pasojë e goditjes së fortë, vdiq në

vend e reja Elona Demaj, ndërsa i fejuari i saj, njëkohësisht dërrigues i mjetit, Ahmet Cokaj pësoi dëmtime, por ndodhet jashtë rrezikut për jetën në spitalin e Koplikut. Pas kryerjes së veprimit të mjetit, llogaritur se aksidenti ndodhi për shkak të shpejtësisë së mjeteve. Nderkohë mbrejnë në aksidentin rrugës Korçë Bilisht humbi jetën 48-vjeçari Myhedin Dervishi. Si pasojë e aksidentit, viktima ishte duke lëvizur me një traktor pa targa, kur u përplas nga një makinë tip "Benz" që drejtohej nga Nikollaj Tona. Mësohet se në këtë aksident u plagos dhe 51-vjeçari Tona.

brshll.ba.be